



BASHKIA
TIRANË

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 76, datë 26.07.2017

PËR

“MIRATIMI I KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR MBI PROGRAMIN E BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND OSE ME FONDET E BUXHETIT VENDOR”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 21 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, vendimit nr. 955, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”; udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 të Ministrisë të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë “Për përfitimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshillit Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë **kriteret** mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor.
2. Familjet në nevojë përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar dhe kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni brenda tre muajve të fundit nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur fitues.
3. Numri i familjeve përfituese do të jetë i barabartë për çdo njësi administrative. Nëse Njësia Administrative nuk plotëson numrin e familjeve në nevojë, struktura përgjegjëse për shërbimet Sociale në Bashki do të vlerësojë familjet më në nevojë nga njësitë e tjera administrative. Prioritet do të kenë familjet me nevoja sociale ekonomike të theksuara.
4. Të miratojë **procedurat** mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor.
5. Sipas pikës 4 të këtij vendimi, Njësia Administrative përpunon listën e përfituesve të mundshëm dhe vlerëson dosjet për t’u trajtuar me këto fonde dhe përcjell pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale listën e përfituesve të mundshëm dhe dokumentacionin e duhur dhe të plotë.

6. Njësia Administrative propozon masën e ndihmës ekonomike për çdo familje, në mbështetje të udhëzimit nr.4, datë 17.12.2017 të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”..
7. Në zbatim të këtij vendimi struktura përgjegjëse për shërbimet Sociale në Bashki në bazë të propozimeve dhe vlerësimeve Social Ekonomike të ardhura nga njësitë administrative për trajtim me ndihmë ekonomike, shqyrton, vlerëson dosjet sipas kriterëve, procedurave dhe sistemit të pikëzimit, si dhe harton projekt vendimin për familjet në nevojë nën juridiksionin e Bashkisë.
8. Të miratojë **dokumentacionin** mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, si më poshtë:
 - a. Vlerësim Social Ekonomik.
 - b. Kërkesë me shkrim.
 - c. Fletë përmbledhje e daljes nga sistemi pikëzimit.
 - d. Vërtetim KMCAP.
 - e. Fotokopje e çertifikatës familjare
 - f. Fotokopje e kartës së identitetit.
9. Të miratojë **sistemin e pikëzimit** mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
10. Familjet e përzgjedhura do të përfitojnë ndihmën ekonomike nga programi i bllok-ndihmes 6% ose fondi i vënë në dispozicion nga Bashkia e Tiranës në programin e kujdesit social projekti “Mbrotja sociale për kategorinë e familjeve në nevojë të përjashruara nga skema e ndihmës ekonomike” në buxhetin e vitit 2017.
11. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
12. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI